

Si të kerkosh ndihmë

Na telefononi në numrin **0682124489** dhe merrni informacione, mbështetje ballë për ballë ose referim për mbështetje të mëtejshme në institucione shtetërore ose organizata - ose na kontaktoni përmes formularit të faqes në internet në **www.hrdc.al** ose na shkruani direkt në **e-mail: qdnjd@albaniaonline.net**



Photo by ©2020 Transcendent Media Capital

Viktima e krimit kanë këto të drejta



Të drejtën për të përfituar kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike dhe shërbime të tjera

Të drejtën për të zgjedhur mbrojtës dhe për të përfituar ndihmë juridike falas



Të drejtën për të kërkuar kompensim për dëmet e pësura

Të drejtën për tu përjashtuar nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore



Të drejtën për tu akomoduar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore (strehëza)

Të drejtën për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit (për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit)



Shërbime

QDNJD ka një përvojë 15 vjeçare në ofrimin e shërbimeve falas për grupet në nevojë, përfshirë shërbime sociale, psikologjike dhe ligjore përmes Qendrës së Këshillimit dhe Ndihmës Ligjore.

Konkretisht, QDNJD ofron:

- Hartim dokumentacioni ligjor (kërkesë - padi, kërkesë për apel, kërkesë drejtuar institucioneve shtetërore, etj);
- Ofrim i konsulcencës juridike për çështje të natyrës civile dhe penale;
- Përfaqësim ligjor falas në gjykatë për grupet në nevojë, për çështje me objekt lëshimin e urdhërave të mbrojtjes;
- Shërbime paraligjore (Ndërhyrje për zgjidhjen e çështjeve administrative apo të tjera);
- Shërbime Klinike (aftësimi i individëve për ndjekjen e çështjeve të tyre përpara institucioneve administrative apo gjyqësore);
- Adresim në qendrat e specializuara sipas kategorisë së çështjeve ligjore të paraqitura;



Photos by ©2020 Transcendent Media Capital

Rreth



Photo by ©2020 Transcendent Media Capital


Qendra Të Drejtat e Njeriut në Demokraci (QDNJD) është organizatë joqeveritare, jofitimprurëse që synon të punojë për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Në vitin 2019, QDNJD është akredituar nga Parlamenti Shqiptar si një organizatë influencuese lobiste.

Përmes programeve shumëplanëshe, QDNJD punon në drejtim të parandalimit dhe adresimit të të gjitha formave të dhunës, publikon raporte periodike mbi situatën e dhunës, bën rekomandime mbi legjislacionin e dhunës dhe zhvillon programe trajnimi të specializuara dhe të vazhdueshme për të gjithë profesionistët në sektorët e sigurisë, mbrojtjes sociale dhe drejtësisë në mënyrë që ata të zbatojnë ligjet ekzistuese. QDNJD është një nga organizatat e pakta që ofrojnë përfaqësim falas në gjykatë për viktimat e dhunës dhe mbështet funksionimin e Mekanizmit të Kordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në disa bashki.

QDNJD gjithashtu monitoron në praktikë zbatimin e legjislacionit nga institucionet shtetërore përgjegjëse. Përfaqësimi në gjykatë i të mbijetuarave, në kombinim me ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin individual të rasteve ka bërë të mundur që organizata të hartojë dhe adresojë rekomandime thelbësore për përmirësimin e legjislacionit të dhunës në familje. Kontributet e QDNJD në ndryshimet e ligjit për dhunën (2008, 2010, 2018, 2020) kanë përmirësuar përkufizimet ligjore të dhunës në familje në përputhje me Konventën e Stambollit dhe Konventën e CEDAW.




Nëse je viktimë krimi, telefono për mbështetje falas dhe konfidenciale



068 212 4489



<https://www.hrdc.al>



KËRKONI SIGURINË TUAJ

Së bashku NE mundemi



With Financial support from
the Justice Programme
of the European Union



Victim Support
Europe



Pagalba
nusikaltimų
aukoms

